

BEQIR META

**MARRËVESHJA E MUKJES NË KONTEKSTIN E POZITËS
NDËRKOMBËTARE TË SHQIPËRISË GJATË
LUFTËS SË DYTË BOTËRORE***

Fillimi i Luftës së II Botërore paralajmëronte jo vetëm një tragjedi të madhe njerëzore, por edhe një tronditje të pozitive ndërkombëtare, të stabilitetit dhe legjitimitetit ndërkombëtar të shumë vendeve. Është e kuptueshme që ndër më të rrezikuara ishin vendet e vogla.

Pozita ndërkombëtare e Shqipërisë në këtë kontekst të zymtë ishte ndoshta më e kërcënuara dhe më e rrezikuara. Në këtë situatë ndikonin një sërë faktorësh:

Së pari: Shqipëria ishte viktima e parë e agresionit fashist në Evropë. Kjo ishte një arsye që ky agresion nuk u dënua nga Fuqitë e Mëdha me forcën e qartësinë e duhur. Kjo lidhej me momentin kur u krye pushtimi, pasi në këtë kohë Italia nuk ishte renditur në bllokun fashist dhe Fuqitë Perëndimore, në mënyrë të veçantë Britania e Madhe, përpiqeshin ta afronin ose të paktën ta mbanin në një pozicion neutral Italinë. Kjo ishte një arsye që pas pushtimit nuk u përcaktua e nuk u njoh me qartësi pozita ndërkombëtare e Shqipërisë si një viktimitë e pafajshme e agresionit fashist. Kjo u manifestua si në qëndrimin që u mbajti ndaj qeverisë legjitime shqiptare në ekzil ashtu dhe ndaj rezistencës. Ai ishte një qëndrim mohues, izolues dhe mjaft cinik.

Gjatë kësaj lufte pozita e Shqipërisë midis dy blloqeve ushtarake ndërluftuese ishte afërsisht midis Shillës e Karibës. Një aleat i detyrueshëm i saj i kohës së paraluftës, që bënte pjesë në bllokun fashist - pra Italia e kishte pushtuar ushtarakisht atë dhe e kishte përdorur territorin e saj si një placdarmë për agresionin në Ballkan. Në anën tjetër Fuqia më e Madhe prezente në Ballkan e kampit antifashist nuk jepte garanci për pavarësinë e mbrojtjen e integritetit të saj territorial. Pra Shqipëria jo vetëm që ishte e vogël dhe e dobët, por nga të gjitha anët i mungonin Aleatët e sigurt e parimorë. Pikërisht për këtë arsye ajo nuk ishte thirrur të merrte pjesë në nënshkrimin e Kartës së Atlantikut.

* Kumtesë e mbajtur në sesionin shkencor kushtuar 65-vjetorit të Marrëveshjes së Mukjes, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë, 1 gusht 2008.

Së dyti, pushtimi italian ishte shumë fatkeq më së shumti sepse ndërpreu procesin e shkurtër të stabilizimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptar, i cili efektivisht pati në dispozicion për zhvillimin paqësor të tij një periudhë që nuk i arrinte dy dekadat. Kjo ka pasur një sërë implikacionesh të brendshme dhe ndërkombëtare.

Në planin ndërkombëtar shteti shqiptar nuk ishte pranuar në mënyrë definitive e të qëndrueshme si një entitet apo subjekt i pacenueshëm, i respektueshëm dhe i mirëseardhur. Pas Konferencës së Londrës së vitit 1913, menjëherë kishte vijuar Traktati i Fshehtë të Londrës, i cili kishte nënshkruar edhe dy Fuqi të Mëdha europiane, që tashmë ishin renditur në krahun antifashist. Po këto fuqi kishin vënë në pikëpyetje ekzistencën e shtetit shqiptar në Konferencën e Versajës në vitet 1919-1920 dhe me shumë vështirësi kishin pranuar ta rinjihnin pavarësinë e Shqipërisë në vitin 1921.

Shqiptarët me shumë mundime e vështirësi arritën që të siguronin një stabilitet dhe progres modest të shtetit të tyre në vitet '20, '30. Por këto përpjekje dhe këto arritje nuk u vlerësuan si një argument i mjaftueshëm nga diplomacia dhe politika europiane, duke përfshirë këtu edhe vendet antifashiste, për të respektuar me konsekuencë pavarësinë e Shqipërisë. Gjatë Luftës II Botërore ajo u konsiderua prej Britanisë së Madhe, që ishte fuqia kryesore antifashiste europiane, si një subjekt mbi të cilin mund të bëheshin ndryshime e operacione në favor të interesave strategjike britanike dhe të lakmive të fqinjëve tanë - grekëve e serbëve.

Dëshmia më e qartë e kësaj politike ishte deklarata britanike e 17 dhjetorit 1942, e cila vinte në pikëpyetje si pavarësinë ashtu dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë, të cilat i konsideronte si çështje që do të diskutoheshin në Konferencën e Paqes pas luftës.

Së treti: Çështja e pazgjidhur kombëtare shqiptare ishte një rrezik i madh për popullsinë e mbetur jashtë kufijve politikë, pasi ajo në koniunkturën e turbullta të Luftës së II Botërore rrezikonte të pësonte shfarosjen, genocidin dhe spastrimin etnik. Por sikur të mos mjaftonte ky rrezik tepër i madh e real, copëtimi i trojeve shqiptare ishte kthyer në një gur të madh që i varej në qafë shtetit shqiptar duke rrezikuar ta fundoste atë. Dallgët e ngritura prej stuhisë së Luftës II Botërore ishin aty për të ndihmuar në fundosjen e tij.

Atëherë përballë këtyre rreziqeve të mëdha dhe të paanë, cilat ishin shanset e shqiptarëve për të mbijetuar ata dhe shteti i tyre, që kishte qenë arritja më e madhe historike e tyre?

Ata gjendeshin pa aleatë reale e të sigurtë, ishin të dobët ushtarakisht, me potenciale të kufizuara njerëzore e ekonomike për t'u bërë ballë rreziqeve, të ekspozuar ndaj goditjeve nga të gjitha anët. *E vetmja mundësi, e vetmja armë e rëndësishme që ata mund ta dispononin ishte bashkimi politik i tyre.* Klasa politike shqiptare brenda dhe jashtë Shqipërisë, e vjetra dhe e reja, duhej të bënte sakrificat më sublime për të shmangur diversitetin dhe çdo lloj konflikti

politik, të kapej fort pas legjitimitetit të shtetit shqiptar si subjekt ndërkombëtar dhe të bënte të gjitha përpjekjet për ta potencuar atë në mënyrën më maksimale.

Shumica e kësaj klase politike e kishte këtë ndërgjegje dhe i kuptonte përgjithësisht rreziqet. Veprimet e saj në drejtim të bashkimit dhe unitetit politik mund të thuhet se kulmuan në tre ngjarje kryesore:

- 1- Përpjekjet relativisht të suksesshme të Mbretit Zog në ekzil për të formuar një Front të Bashkuar Kombëtar, të cilat iu afruan shumë suksesit, i cili duket se do të kishte qenë i sigurt po të mos ishte siluruar e asfiksuar nga qeveria britanike.
- 2- Konferenca e Pezës, e cila u mbledh me iniciativën e komunistëve dhe u përkrah nga një grup nacionalist.
- 3- Marrëveshja e Mukjes, e cila bashkonte forcat e dy grupeve më të mëdha politiko-ushtarake në Shqipëri.

Rezultati historik i këtyre tre përpjekjeve ishte dështimi. Analiza për këtë mund të jetë shumë e gjerë dhe del jashtë objektit të kësaj kumtese, por shkurtimisht mund të thuhet disa fjalë:

Iniciativa e A. Zogut dështoi se ishte jashtë Shqipërisë, e izoluar nga atdheu dhe terreni i luftës. Ajo u sabotua nga britanikët, pra pati kundërshti të fortë ndërkombëtare. Por duhet shtuar edhe diçka, që ndoshta nuk është thënë deri më tani, asaj i mungoi energjia dhe largpamësia për t'u zhvendosur dhe kthyer në një faktor potent politik në Shqipëri edhe jashtë dëshirës së britanikëve. Se sa dhe si mund të bëhet kjo, është çështje që kërkon një analizë e diskutim të gjatë.

Konferenca e Pezës ishte një përpjekje për bashkim në luftë e konceptuar sipas stilit dhe objektivave komuniste. Ajo e kuptonte frontin si bashkim politik që do të drejtohej dhe dominohej nga PKSH. Vetë iniciativa për thirrjen e Konferencës synonte të realizonte këto objektiva. Koha pas konferencës e provoi shumë shpejt këtë. Konferenca dhe pjesëmarrësit e saj nga të gjitha krahët, nuk shprehën asnjë ide apo projekt për bashkimin rreth qeverisë legjitime të parapushtimit, madje heshtën totalisht për këtë sikur ajo të mos kishte ekzistuar kurrë. Kjo është një dëshmi se ata nuk ishin aq të ndërgjegjshëm për rreziqet që i kanoseshin shtetit shqiptar dhe se rikthimi i legjitimitetit të tij nuk vlerësohej si një element esencial i bashkimit.

Marrëveshja e Mukjes ishte një hap përpara sepse ajo synonte ta realizonte bashkimin duke vënë në balancë dhe duke harmonizuar e koordinuar të dy blloqet politiko-ushtarake që ekzistonin deri në atë kohë në Shqipëri. Iniciativa e marrë nga Balli Kombëtar ishte me të vërtetë në drejtimin e duhur për mbrojtjen e interesave kombëtare shqiptare dhe për ta përgatitur vendin që të përballlej me efektivitet në koniunkturën e komplikuar ndërkombëtare të periudhës së luftës, të cilat kishin shumë të njohura e të panjohura shumë shpresa e rreziqe.

Por edhe iniciatorët e kësaj marrëveshje deri në këtë kohë kishin pasur një koncept jo të plotë për bashkimin. Ata kishin nënvleftësuar, për arsye të armiqësive të vjetra politike, bashkëpunimin me ish qeverinë shqiptare të 1939-tës, pra me pasuesit e A.Zogut, duke mos e kuptuar se ky bashkim dhe njohja e legjitimitetit të qeverisjes së vitit 1939 ishte një element thelbësor për mbrojtjen e interesave dhe pozitave të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Pikërisht si rezultat i kësaj neglizhence e mosbashkëpunimi britanikët e patën më të lehtë të izolonin Zogun dhe iniciativat e tij politike, ndërsa jugosllavët e patën më të lehtë të manipulonin lëvizjen komuniste shqiptare dhe të nxisnin luftën civile.

Nga ana tjetër në momentet kur u nënshkrua marrëveshja, forcat nacionaliste nuk ishin në gjendje ta impononin atë duke përdorur potencialin politiko-ushtarak të tyre. Duke e parë në këtë këndvështrim ky nuk ishte momenti i favorshëm për ta. Është e qartë se kur tentohet arritja e një marrëveshje ka shumë rëndësi momenti, sepse ai përcakton pozitat e palëve. Ka mjaft të dhëna se lëvizja komuniste dhe rreziku i saj ishte nënvleftësuar deri diku. Ishte nënvleftësuar mjaft edhe roli dominues i mentoreve jugosllave të kësaj lëvizje dhe rreziqet që buronin prej tij.